

KLARA KODRA**BOTA POETIKE E DRITËRO AGOLLIT**

Në letërsinë shqiptare, për shkak të veçanësisë së saj, zhvillimit me vonesa dhe shpërthime, në krahasim me letërsitë e tjera evropiane, gjithashtu edhe rëndësisë së madhe që i jep kjo letërsi mesazhit, është vështirë të flitet për poetika të drejtimeve letrare. Nga ana tjetër vihet re një larmi poetikash autoriale, larmi që erdhi duke u rritur në shekullin e njëzetë, veçanërisht në gjysmën e parë të këtij shekulli dhe vihet re madje edhe në kohën e një drejtimi të tillë të ngurtë siç qe realizmi socialist.

Ky drejtim që në fillimet e veta synonte të ishte shkrirje e realizmit dhe romantizmit, u shndërrua shpejt në një neoklasicizëm që me rregullat e veta të ngurta rrezikonte t'i nivelonte individualitetet krijuese.

Po edhe në brendësi të tij mundën të dallohen individualitete krijuese origjinale që e thyen lëvozhgën e ideologjizimit dhe të skemave.

Madje, në vitet '60 lindi një avangardë autorësh të talentuar që e shpëtoi letërsinë shqiptare nga mediokriteti ku rrezikonte të fundosej në vitet '50 nën trysinë e skemave të ngurta, retorikës artificiale romantizante dhe folklorizmit.

Kjo avangardë - një treshe poetësh të afërt midis tyre e megjithatë shumë të ndryshëm - ripërtëriu figuracionin duke e shpëtuar nga figurat tradicionale të ngurosura, leksikun poetik duke e afruar me gjuhën e gjallë, metrikën duke lëvruar vargun e lirë dhe të çlirët, tërë formën duke thithur nga realizmi e madje duke shfrytëzuar disa elemente nga teknikat moderniste që kaluan në mënyrë klandestine gardhin e censurës.

Krijimtaria e këtyre poetëve dëshmon për vitalitetin e talenteve të mirëfillta që gjejnë forma të fshehta për të luftuar me konformizmin zyrtar të diktaturave që synojnë gjithnjë për nivelim dhe sterilizim të letërsisë.

Dritëro Agolli bënte pjesë në këtë avangardë, po edhe dallohej prej saj.

Ai qe kryesisht poet *i detajit* konkret, ndërsa bashkëkohësi i tij Kadare qe poet i figuracionit të guximshëm dhe polivalent, (s'po themi se poezisë së Agollit i mungon figuracioni, madje tek ai mund të gjejmë figura befasuese dhe të freskëta, po ky autor parapëlqen detajin), është poet *i qartësisë*, ndërsa Kadareja dhe më shumë Arapi, synonin për errësi, për hermetizëm, (do ta lidhnim këtë tipar me një "poetikë të fëmijës" në poezinë e Agollit për të cilën do të kemi rast të flasim më poshtë), poet *fshatar*, ndërsa dy të tjerët poetë *qytetarë*.

Tok me bashkëkohësit e avangardës së 1960-ës, Agolli e përtërin leksikun poetik që ishte ngurtësuar nga disa modele tradicionale romantike-folklorike, duke i hapur dyert leksikut të zakonshëm, bisedor, në dukje jo poetik.

Ky poet përdor emërtimet e sakta të faunës dhe të florës, shfrytëzon begatinë e frazeologjisë popullore, nuk i trembet të ashtuquajturit “vulgaritet” (sjell në poezi *këpucët, baltën, nagantin, çeqet, cigaret, bobinat, asfaltin, telefonin*).

Edhe Agolli si dy poetët e tjerë është për një reformë të vargut që do ta përtërijë poezinë e viteve ‘60, duke mos vënë megjithatë në bazë të poezisë së vet vargun e lirë të mirëfilltë, po më tepër vargun e thyer, vargun e rregullt të çlirët që nuk u përmbahet rregullave në mënyrë rigoroze ose që përdor shpesh asonanca në vend të rimës.

Agolli spikat në avangardën e 60-ës për afërsinë me poezinë popullore, ndonëse edhe dy të tjerët nuk e mohojnë krejt traditën e gjatë të të ushqyerit nga folklori që e dallon letërsinë shqiptare.

Prej folklorit poeti merr disa lloje vargjesh si gjashtërokëshin, tetërokëshin, dhjetërokëshin, një strofë karakteristike si distiku, figuracionin e freskët dhe spontan, disa motive, filozofinë e shëndetshme për jetën, vdekjen, dashurinë. Poeti pranon veçoritë e kodit estetik popullor si *idealizmin, përsëritjen* që luan një rol të veçantë në muzikalitetin, i pranon këto veçori duke i përpunuar në mënyrë krijuese pa rënë në folklorizëm. Duke u mbështetur te filozofia popullore, poeti e sheh jetën si *gëzim*, po edhe si *luftë* edhe si *dhimbje*, asnjëherë si absurditet, si kotësi; dashurinë si *gëzim/dhimbje*, po edhe si përtëritëse e jetës, edhe si përkushtim që mund të zgjasë deri në vdekje nëpërmjet familjes. Vdekjen e sheh si armike për ta sfiduar, po edhe si pjesë të procesit natyror dialektik që duhet pranuar me *stoicizëm* edhe si *sprovë* për besnikërinë ndaj idealit që nënkupton edhe *flijimin*. Nuk e sheh asnjëherë si ekzistencialistët si tregues të absurditetit të jetës, as në frymë fetare, si kalim drejt një bote më të mirë.

Poezia e Agollit është çuditërisht spontane, e gjallë, dinamike, plot ngjyrë.

Kjo poezi është plot ngjyra dhe aroma.

Tokën, një simbol që përshkon tërë poezinë e tij poeti e identifikon me aromën.

Veçse në këtë poezi gjejmë plot aroma të tjera, poetike ose jo: erën e limonit, erën e grurit dhe pjeshkës, erën e jonxhës, erën e mendrës, erën e djersës (që vjen shpesh në lirikat e tij si një leitmotiv për të shprehur kultin e

punës), erën e jargavanit (në lirikën aq fine për natën “Malli”¹), erën e mollëve (“Mollët”²), madje erën e *çokollatës* për të vizatuar portretin e një gruaje jeta e së cilës i ngjan një *çokollate-bombone* në kuti (“Kjo grua”³).

Edhe për sa u përket ngjyrave, palitra e poetit dallohet për larmi: gjejmë ngjyrën e *bardhë, të zezë, të kuqe, të artë, të kaltër, bojë hiri, të gjelbër, të verdhë* (poeti shfaq origjinalitet në togfjalëshin trishtim *i verdhë*, duke mos e lidhur trishtimin me epitetet e njohur *i zi* dhe *bojëhiri*, po duke krijuar analogji me një fytyrë *të verdhë*, pra, *të zbetë*, pa jetë).

Pra poezia e Agollit është *polikromatike*.

* * *

Një vend të veçantë në krijimtarinë e këtij poeti zënë *toka* dhe *fusha*, qoftë si imazhe konkrete, qoftë si simbole me të cilat poeti hyn në dialog të ngrohtë (Tokë e dashuri... diçka të kërkuar nga unë⁴ - Toka ime, kënga ime).

Ato identifikohen, herë me *nënë*, herë me *gruan*, dy dashuritë më të mëdha të jetës së njeriut dhe konkretisht të poetit.

Përveç tyre nuk mungon simboli karakteristik shqiptar i malit që shtegton nga poeti në poet, po të cilit Agolli i këndon në mënyrën e vet, duke mos e parë si Kadareja në përpjesëtime vigane, as si forcë shtypëse si Migjeni, po më tepër duke e afruar me heroin lirik (të sjellim ndërmend vargun e magjishëm të një lirike “Malet unë me frymën i ngroh”⁵). Madje shfaqet edhe imazhi i detit, i rrallë në poezinë tonë, i cili edhe e magjeps edhe e tremb poetin siç shohim në vjershën “Kur më pushtoi malli për detin”⁶ ku përshkruhet takimi i parë me detin i poetit fëmijë.

Veçse ky imazh nuk është i gjithëpranishëm siç ndodh përkundrazi me Arapin, një poet bregdetar, po shfaqet në pak lirika me veçanësinë e tij joshëse dhe të frikshme. Mund të thuash se Agolli është një poet piktor që krijon pejsazhe dhe portrete.

A mund të harrohet vogëlushja “e zbetë si hëna” “me fjongo të gjelbër në gërshet”? (“Me fjongo të gjelbër”)⁷.

¹ D. Agolli, *Vepra letrare*, Vëllimi 1, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1980, f. 136-137.

² Po aty, Vëllimi 3, f. 57.

³ D. Agolli, *Vepra letrare*, Vëllimi 1, f. 144.

⁴ D. Agolli, *Poezi*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1972, f. 282.

⁵ D. Agolli, *Kur bie dëborë*, Vepra letrare, Vëllimi 1, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1980, 141.

⁶ D. Agolli, *Udhëtoj i menduar*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1985, f. 89.

⁷ D. Agolli, *Vepra letrare*, Vëllimi 1, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1980, f. 212.

Apo turkeshja “me sy të zez e vetullzezë, / me flokët “lyer me këna” (Turkeshja)?⁸

Ka edhe portrete provokues ku theksohen tiparet prozaike si portreti i hidraulistes me vetulla jo të zeza, po “me pluhur”, me këmbë jo të vogla, po *të mëdha*, me duar *të plasura*, jo të bardha porsi borë, të vogla, të buta (“Dashuri dhe ferrobeton”).⁹

Ky portret të sjell ndër mend ekspresionizmin dhe futurizmin, elemente të të cilave kishin depërtuar në drejtimin e realizmit socialist, ndonëse ky drejtim i kundërvihej modernizmit.

Kjo mënyrë portretizimi mund të lidhej edhe me konkretësinë e poezisë popullore, veçse në estetikën popullore, siç thamë edhe më lart, ka zënë vend parimi i *idealizimit*. Këngëtari popullor vërtet nuk u këndon bukurive të zbehta sentimentale, po vajzave faqekuqe, plot lëng jete në dejet e tyre, megjithatë portretet femërore në folklorin shqiptar spikasin për finesë.

Pejsazhet e Agollit janë origjinale. Herë të befasojnë me konkretësinë (Zogjtë vënë këmbët e vogla në këmishët e ndera / Në këmishët e lara të varura në pemët, / sikur t’i mbajnë me kopsa, t’i ruajnë nga era. / Gratë litarë e tela në degët, / me duart e njoma nga uji ndejnë të tjera këmishë/¹⁰ që duken së largu ngjyra-ngjyra si fletët. - “Fshatarkat lajnë këmishë /; “Gjithçka mbulon kjo pelte e trashë: / Pellgjet që mbanin baltë e fletë të kalbura, / Vrimat që fshihnin gozhdë patkonjsh e kashtë, / Vijat e ujit që sillnin luspa shalqini të lagura ... / Tundin krahët mimozat në asfaltin – pasqyrë / Dhe hedhin balluket si vajzat në ballë / Për të parë bukurinë e tyre, / Që s’e shihnin dot në livadhe ...” - “Pejzazh asfalti”¹¹, herë janë ngjyrosur me ndjenjën e poetit (“I shkujdesur eci bregdetit të mirë, / Thërmijëzat e rërës më guduhsin këmbët e zathura, / Era flokët m’i krip me kripën e shkrirë, / Jodi i padukshëm m’i lyen buzët e plasura ... / Dhe shkrihet në fytyrën time një buzëqeshje rinie / një buzëqeshje e bashkuar me shushurimën e valëve “ Duke udhëtuar anës detit¹².

“Po zbresim nga malet ne të dy: / Shkumbini dhe unë) Unë kam qeleshe të bardhë mbi sy / Ai ka shkumë - “Unë dhe Shkumbini”¹³; “Jam mbështjellë prej blerimit / Valë e vakët më përkund, / Humb në mes të gjelbërimit, / Humb se erdha që të humb; ... kërkoi strehim i shkreti / Në të

⁸ D. Agolli, *Udhëtoj i menduar*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1985, f. 58.

⁹ D. Agolli, *Vepra letrare*, Vëllimi 1, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1980, f. 296.

¹⁰ D. Agolli, *Udhëtoj i menduar*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1985, f. 175.

¹¹ D. Agolli, *Vepra letrare*, Vëllimi 3, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1980, f. 73.

¹² D. Agolli, *Fjala gdhend gurin*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1977, f. 63.

¹³ D. Agolli, *Vepra letrare*, Vëllimi 1, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, f. 106.

gjelbrën mbretëri / Pasaportën ia firmosën / Zogjtë mbledhur sqep më sqep / Dhe me lule ç'ia vulosën... - "Udhëtim në mbretërinë e gjelbër"¹⁴.

* * *

Pjesë integrale e botës poetike të Agollit është edhe afërsia shpirtërore me "vëllezërit e vegjël", të njeriut, kafshët (lopa, zogu, flutura, kali, kau, qeni, macja), po edhe me bimët dhe dukuritë e tjera të natyrës.

Karakteristike janë tri lirika për lopët.

Nga këto "Bala, lopa ime"¹⁵ u përket fillimeve poetike të Agollit. Portreti i kafshës vizatohet në fillim me ngjyra të gjalla përmes krahasimesh të thjeshta, po të goditura (Ecte rëndë-rëndë si një damë / Kish dy sy të pastër si dy lera / Kish dy brirë të egër si dy kama) dhe më tej me një patos dramatik dhe nota dhimbjeje që e afrojnë me botën njerëzore kur përshkruhet fundi i saj tragjik, vrasja nga pushtuesi (Çeli lulëkuqja mu në ballë / ... Dhe mbetën hapur sytë e saj / Si dy lera pas një shiu të madh / Turbulluar nga rrëke në maj).

Në dy lirikat e tjera dashuria për kafshën plotësohet me idilin - të papërfunduar a potencial - me mjelësen e bukur. Bie në sy një detaj kuptimplotë që shpreh turbullimin e vajzës së re me shumë efikasitet (Nënë bark të lopës ti ngre kokën / Gishti të shpëton nga sisë e saj / Një rrëkezë qumështi bie në tokë / Paska ardhur djali i xha Rizait?" - "Përsëri")¹⁶. Ndërsa në lirikën tjetër "Lopa"¹⁷ poeti mbështet "faqen në shpatullën e saj të madhe..." dhe ndjen "qumështin me shkumë" dhe mjelësja që portretizohet "me sytë e kaltër / Të bukur e të urtë si paqe" hyn në dialog natyrshëm me poetin duke e pyetur "Ju jeni veteriner?" për të marrë si përgjigje fjalët "Jo, poet!" që tingëllojnë si të papritura, po edhe kuptimplotë.

Te paharrueshëm janë edhe "qeni i plakur" i vjershës omonime në botën e ndenjave të të cilit poeti përpiqet të depërtojë apo "kau i bardhë" i vjershës me të njëjtin titull. Ç'mund të thuhet mandej për macen simpatike të vjershës "Macja e apartamentit"¹⁸ që kërkon me ngulm një shok dhe i duket sikur e ka gjetur përmes vezullimit iluzor të vetvetes në pasqyrë apo për macen

¹⁴ D. Agolli, *Lutjet e kambanës*, Toena, Tiranë, 1998, f. 297.

¹⁵ D. Agolli, *Hapat e mija në asfalt*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1961, f. 16.

¹⁶ D. Agolli, *Shtigje malesh dhe trotuare*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1965, f. 41.

¹⁷ D. Agolli, *Vepra letrare*, Vëllimi 3, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1980, f. 74.

¹⁸ D. Agolli, *Udhëtoj i menduar*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1985, f. 146.

e vjershës “Mbesës dhe maces”¹⁹ ku kafsha dhe fëmija sikur shkrihen në një portret të përbashkët!

Poeti u drejtohet me humor edhe kafshëve të tilla që duket sikur s’e kanë vendin në poezi si miza dhe madje bacili (“Ode për mizën”²⁰, Thirrje drejtuar bacilit”)²¹. Madje shpirti i tij i dhemshur e shtyn të ndjejë dhimbje për miun të cilin e ka vrarë vetë (“Miu”)²².

Krahasimi befasues humoristik dhe ironik i cjavit me “një akademik”²³ është tipik për humorin agollian.

Zogjtë e detit i frymëzojnë poetit lirika të ngrohta si zogu që vdiq çuditërisht nga mërzia për krahun e thyer (“Vdekja e zogut të detit”) ose pulëbardha e plagosur”) që “nuk donte të vdiste në dhomë” (“Pulëbardha”)²⁴.

Veçse poeti duket se parapëlqen mbi të gjitha kafshët kalin të cilit do të donte t’i ngrinte “monument” (“Monumenti i kalit”)²⁵ ose me të cilin çuditërisht identifikohet (Sikur të ndodhnin në jetë mrekulli / Që njeriu të kthehej në një qenie tjetër të gjallë / Dhe mua të më pyetnin se ç’dëshiroja të isha / Unë sigurisht do përgjigjesha: kalë” (“Dobësia ime për kuajt”)²⁶.

* * *

Një tipar i poezisë së Agollit është dashuria e zjarrtë për jetën dhe gëzimet e saj. Këndej e ka burimin edhe ajo limfë jetësore që rrjedh në tërë vargjet e tij. Do të mund ta quanim “poezi diellore” (ndonëse në këtë poezi zë vend edhe imazhi i natës. Ndofta ky imazh ka ndryshuar në periudhën e dytë të krijimtarisë së Agollit ku lidhet më tepër me motivin e trishtimit ekzistencial dhe pleqërisë, ndërsa në periudhën e parë identifikohet më tepër me bukurinë, dashurinë dhe krijimin).

* * *

Lirika agolliane e dashurisë rrok dy periudhat e krijimtarisë së tij, atë të fillimit dhe atë të njëzet vjetëve të fundit. Që në periudhën e parë ajo spikat për ngrohtësi lirike, madje edhe për nota të lehta sensualizmi, megjithatë të përmbajtura.

¹⁹ D. Agolli, *Fjala gdhend gurin*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1977, f. 101.

²⁰ D. Agolli, *Fletorka e mesnatës*, Shtëpia Botuese “Dritëro”, Tiranë 1998, f. 29.

²¹ D. Agolli, *Po aty*, f. 137.

²² D. Agolli, *Po aty*, f. 136.

²³ D. Agolli, *Udhëtoj i menduar*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1985, f. 165.

²⁴ D. Agolli, *Këmbana e largët*, Shtëpia Botuese “Dritëro”, 1998, f. 62.

²⁵ D. Agolli, *Vepra letrare*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1987, f. 11.

²⁶ D. Agolli, *Udhëtoj i menduar*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1985, f. 168.

Konceptimi i dashurisë nga Agolli është jetësor, i shëndetshëm, ndonëse poeti nuk u shmanget momenteve të trishtimit për dashuritë pa përgjigje ose që kanë marrë fund. Mund të përmendim disa vargje të vjershës “Nga kujtimet e hershme”: “Më kish lënë për gjithnjë e bukura / E kuptova që s’duhet t’i bija pas këtë natë / E kuptova që s’donte nga unë të puthura...”²⁷

Në lirikën erotike të Agollit mbizotëron koncepti i shëndetshëm për gruan shoqe të jetës dhe bashkëpunëtore e mbështetje për burrin (“E bukura”²⁸, “Çast”²⁹, “Larg qytetit”)³⁰ si edhe për një qenie në thelb më delikate e fine se sa burri pavarësisht nga mashkullorizimi i saj i shpallur (“Hesht dhe kryet në gjoks m’i mbaj / Flokët ngadalë ledhatomë / Është i etur / për ledhatim / Ai që baltëra ka çarë ... - “Pranë saj”³¹; “Ne bashkë hajt të shkojmë larg në male / Në vende aq të kaltra, aq të bukura; / Të rrjedhë gazi yt në buzë e faqe / Të zërë dora jote e vogël flutura - “Larg do të të shpie”³².

Agolli sheh evolucionin e ndjenjës së dashurisë që ndryshon duke ruajtur thelbin (... gjurmëve të ndoqa / Si kaprollin kreshtave në shkëmb / ç’më ndezi e se ç’hoqa / gjersa ti më quajte burrin tënd? / ... malli në Munellë / Më pushton për ty dhe qetë s’rri ... “Larg qytetit”)³³.

Poeti i bën vend në poezinë e vet temës së dashurisë bashkëshortore, madje me frymë polemike (Gabohe mi shumë kur flasim e grijmë / ... Se gjoja gratë tona e humbën freskinë / ... Ah, vëllezër, s’humbet hijeshia e tyre / Ato përtërihen, ato lulëzojnë / Mjafton të qëndrojnë pak në pasqyrë / Dhe bëhen prapë vajza të njoma ...) ³⁴. Heroi lirik shpreh madje besim në përjetësinë e kësaj ndjenje që do ta mposhtë vdekjen (... kur të jesh mërzhitur shumë / Në raft të librave kërkomë)³⁵.

Një figurë befasuese, e përshkruar nga sensualizmi, është ajo që përdor poeti në periudhën e tij të dytë krijuese për këmbët e gruas si “kitarë prej mishi” (“Kitara prej mishi”). Në vjershat e kësaj periudhe gjejmë edhe imtësira prozaike që pasqyrojnë gjurmët e lëna nga koha që shkon (“Lamtumira e dhëmbëve”).

²⁷ D. Agolli, *Poezia shqipe*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1972, f. 87.

²⁸ D. Agolli, *Vepra letrare*, Vëllimi 1, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1980, f. 234.

²⁹ *Po aty*, f. 224.

³⁰ D. Agolli, *Poezia shqipe*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1972, f. 213.

³¹ *Po aty*, f. 118.

³² *Po aty*, f. 88.

³³ *Po aty*, f. 213.

³⁴ D. Agolli, *Vepra letrare*, Vëllimi 1, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1980, f. 248.

³⁵ D. Agolli, *Lutjet e kabanës*, Toena, Tiranë 1998, f. 248-149, f. 339.

Te Agolli nuk ndodhi kurrë ajo dukuri që karakterizoi disa vepra të realizmit socialist dhe që studiuesja Dhurata Shehri quan “kolektivizim të subjektit lirik”³⁶, madje un-i lirik në poezinë e tij ka një individualitet tepër të veçantë dhe të fuqishëm³⁷.

Me të drejtë studiuesi Shaban Sinani pohon se “D. Agolli... është prurësi i poezisë së un-it të fortë përkundër poezisë së mëparshme që ... karakterizohet nga prirja e shkrirjes së un-it në emrin e brezit”³⁸.

Heroi lirik i Agollit është intelektual i origjinë fshatare me pasione të forta që dashuron dhe urren, që ngrihet kundër padrejtësisë, një poet luftëtar që mbron të renë kundër së vjetrës.

Dhe çuditërisht pranë tij jeton edhe një fëmijë çapkën me çiltërsinë dhe naivitetin e fëmijës që shpalos botën e vet shpirtërore me natyrshmërinë e një fëmije. Mund të themi që në poetikën e Agollit një komponente e veçantë është “poetika e fëmijës” që shpallte dikur poeti i shquar italian dekadent Paskoli, poetika e “fëmijës” që çdo njeri ruan në nënvetëdijen e tij po që gjen mishërimin e vet më të natyrshëm te poeti.

Ky “fëmijë” është “enfant terrible” i periudhës së parë që nuk pranon “rregullat e lojës”, të vendosura nga diktatura për poetët. Po ai “fëmijë” jeton edhe te poeti i moshuar i periudhës së dytë të krijimtarisë që zë fill pas viteve 90-të. Heroi lirik rrëfen me sinqeritet që s’ka thënë gjithnjë të vërtetën, po s’mohon vetveten të cilën e quan “dokument historie” me tërë kontradiktat e veta “i ri dhe i vjetër, / Djall dhe shenjtor”.

Vitaliteti i poezisë së Agollit që e bëri t’i mbijetojë drejtimit letrar të realizmit socialist dhe madje edhe dështimit të idealeve utopike që ushqueshkrimtari dhe që e përshtojnë këtë poezi, mund të shpjegohet, duke pranuar një mendim interesant të studiueses Floresha Dado, me kontradiktën e njohur midis “intuitës vëzhguese ndaj realitetit” dhe “pikëpamjeve të autorit”³⁹.

F. Dado pohon me mprehtësi se “aftësia njohëse e problematikës së kohës, marrëdhënia e ndershme me mendimin e pavarur triumfojnë mbi pikëpamjet politike të Agollit”⁴⁰.

Këtë veçori që ndeshet te mjaft shkrimtarë të mëdhenj disa studiues e shpjegojnë si kontradiktë të poetikës së realizmit me pikëpamjet ideore dhe politike të autorit (në këtë mënyrë janë shpjeguar disa kontradikta në veprën e

³⁶ Dhurata Shehri, *Kolektivizimi i subjektit lirik*, “Letërsia shqiptare dhe realizmi socialist”, Studime Albanologjike, 2010, 2, f. 87.

³⁷ *Vjen njeriu i çuditshëm*, Dritëro, Tiranë, 1996, f. 38.

³⁸ Shaban Sinani, *Njeriu dhe dukuria atipike në veprën e D. Agollit*, Shtëpia Botuese “Naimi”, 2011, f. 268. *Për letërsinë shqipe të shek. XX*.

³⁹ Shih Floresha Dado, *Letërsi e painterpretuar*, Shtëpia Botuese “Bota Shqiptare”, Tiranë 2010, f. 227.

⁴⁰ *Po aty*.

Balzakut, realizmi i fuqishëm i të cilit i kapërcente pikëpamjet e tij konservatore në mbrojtje të aristokracisë dhe monarkisë).

Duke iu rikthyer realizmit socialist, realizmi në fakt quhet si komponent i poetikës së tij, po bie në kundërshtim me disa rregulla të ngurtësuara.

Në rastet kur shkrimtari kapërcen “vizionin e vet të jetës” studiuës të tjerë flasin për një konflikt në brendësi të ideologjisë së autorit midis pikëpamjeve teorike dhe një lloj gjykimi për jetën që rrjedh nga përvoja praktike. Një dukuri të tillë do të mund ta quajë edhe si triumf i krijuesit mbi ideologun te një shkrimtar.

Në të vërtetë, në sajë të një dukurie të tillë, vepra e Dantes ka kapërcyer shekujt, pavarësisht nga iluzionet e tij për Perandorin e urtë ose nga konceptet e tij mesjetare për fenë si pohonte edhe Karduçi në vargun kuptimplotë “Vdes Zeusi dhe himni i poetit mbetet”.

Kështu edhe në periudhën e parë të krijimtarisë së Agollit që përfshihet në drejtimin e realizmit socialist shumica e vjershave mbijeton në sajë të pannjerëzores dhe të literalitetit të saj, ndërsa në periudhën e fundit poeti është kthyer te realizmi i mirëfilltë dhe e ka zgjeruar poezinë e tij me një përmasë ekzistenciale.

Motivet e dhimbjes për rininë që ikën, të vdekjes si ankth, të enigmave të jetës mbizotërojnë në këtë periudhë e cila megjithatë s’është shkëputur nga problematika sociale-politike si dëshmon në mënyrë të veçantë cikli plot frymë luftarake për Kosovën.

Fjalët çelës të poetikës së Agollit janë TOKË, BALTË, GUR, UDHË, UDHËTAR.

Në periudhën e fundit kjo poetikë është pasuruar me fjalët çelës PELEGRIN, KËMBANË me të cilat në një frymë gati fetare identifikohet heroit lirik.

Një veçori tjetër e poetikës së Agollit është shtrirja e saj në dy periudha me struktura historike dhe ideologjike të ndryshme, çka përcakton edhe evolucionin e saj, megjithatë poeti duke evoluar, i qëndron besnik thelbit të vet.

Krahas heroit lirik me pasione të forta, që di të dashurojë e të vuajë, kur është rasti edhe të urrejë - në poezinë e Agollit shfaqen figurat e babait dhe të nënës; figura të gjalla, jetësore, jo shëmbëlltyra tradicionale: nëna është “e bukura Hatixhe”⁴¹ që “mbi një minder nën penxhere” lindi poetin, që kur ishte

⁴¹ D. Agolli, *Poezia shqipe*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1972, f. 89.

fëmijë “me mundim / e ndiqte dhe loste te zabeli”⁴², që i ankohet djalit me shqetësimin e përhershëm të nënave “Si s’ të lodhi udha, biri im”⁴³, që kërkon në mënyrë naive dhe absurde “të mbajë shpend në apartament”, që poeti në një poezi e përkufizon si rebele; babai është i rreptë, po edhe si këshilltar i urtë për djalin; që s’do “t’ia hajë qeni shkopin”⁴⁴ atij dhe të birit, që, si thotë poeti me një detaj tepër origjinal që mund të buronte vetëm nga shpirti i një poeti fshatar “i kaltëronte toka nën thonjtë”⁴⁵ edhe kur “ishte shtrirë” në gjumin e fundit (“Puna”)⁴⁶.

Pastaj në poezinë e Agollit gjejmë një minigaleri personazhesh me emër dhe pa emër: vogëlushja që donte të këndonte “Karmenin”⁴⁷, malësori që vjen të shohë të birin në Universitet⁴⁸, kurbatka së cilës ia ka rrëmbyer estrada të birin⁴⁹, Dranja e vogël që ëndërron për shkollën⁵⁰, partizani Meke që i kundërvihet perandorit pushtues⁵¹, trimëresha Maro Podgozhani që mbron vatrën e vet dhe të birin si burrë⁵², “astronomi” i çetës që vdes duke shikuar yjet⁵³, himarjoti që në çastet e fundit shpreh dashurinë për jetën duke parë një degë limoni⁵⁴. Agolli që, siç e pamë, dinte të vizatonte me pak vija të goditura disa portrete fizike, me po atë gjallëri vizaton portrete psikologjike.

* * *

Agolli ka qenë më afër me utopinë socialiste se Kadareja dhe i ka ruajtur më gjatë iluzionet e veta politike, megjithatë syri i tij i mprehtë prej

⁴² D. Agolli, *Vepra letrare*, Vëllimi 1, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1980, f. 86.

⁴³ *Po aty*, f. 90.

⁴⁴ *Po aty*, f. 207.

⁴⁵ Nënvizimi është imi - K.K.

⁴⁶ D. Agolli, *Poemë për babanë dhe për vete*, Vepra letrare Vëllimi 11, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1987, f. 101.

⁴⁷ D. Agolli, *Fjala gdhend gurin*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1977, f. 58.

⁴⁸ D. Agolli, *Hapat e mija në asfalt*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1961, f. 21.

⁴⁹ *Po aty*, f. 39.

⁵⁰ D. Agolli, *Një natë*, Mesditë, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1969, f. 54-55.

⁵¹ D. Agolli, *Krevati i Perandorit*, Mesditë, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1969, f. 6.

⁵² D. Agolli, *Fjala gdhend gurin*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1971, f. 22.

⁵³ D. Agolli, *Vepra letrare*, Vëllimi 1, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1980, f. 114.

⁵⁴ D. Agolli, *Shtigje dhe trotuare*, Dritëro, 1998, f. 94.

poeti edhe në periudhën e diktaturës i dallonte dukuritë negative të realitetit dhe prirej për t'i kritikuar, duke rënë në konflikt me parimin e detyruar të idealizimit. Temperamenti i tij i pasionuar ndjente t'i merrej fryma nga rregullat e ngushta të realizmit socialist dhe kërkonte një shteg daljeje nëpërmjet humorit që shndërrohej hera-herës në ironi, madje edhe në sarkazëm.

Humori agollian është i butë kur tallet me dobësitë njerëzore, është i ashpër kur godet dukuritë negative. Ironia e tij nuk i ngjan ironisë së romantikëve që shkatërrojnë *çka kishin krijuar*, është një ironi që synon të shkatërrojë *për të krijuar*, ndonëse jo rrallë poeti e ka më tepër të qartë negativën *reale* sesa të renë, *idealen*.

Humori dhe ironia agolliane janë larg nga grotesku i Kadaresë.

Nga tradita paraardhëse Agolli kishte ruajtur kultin e atdheut dhe të tokës, këtu ai ka qenë vazhdues i traditës naimjane, po duke e rritur konkretësinë e tablove të realitetit dhe portreteve që pikturon, duke e pasuruar me imtësi të shumëngjyrshme dhe plastike.

Plasticiteti në poezinë e Agollit qëndron përkrah muzikalitetit. Poeti parapëlqen vargun e rregullt, ndonëse nuk u bindet rreptësisht rregullave tradicionale të metrikës dhe synon të një varg i çlirët më tepër se sa të një varg i lirë tek i cili nuk arrin asnjëherë. Poeti e thyen vargun, po vargu i tij i thyer shpesh përbëhet nga vargje të rregullta, e ruan rimën, duke e kultivuar madje rimën e pasur, rimën e brendshme, po e përziën me rimën apofonike, me asonancën dhe me konsonancën.

Shumë vjersha të Agollit ngjajnë tamam si këngë për muzikalitetin e tyre, po nga ana tjetër ai synon për një poezi bisedore që t'i afrohet të folurit të zakonshëm. Do të mund të flisim për një konflikt midis dëshirës për liri të poetit, dëshirës për të mos e mbyllur vargun brenda gardhit të metrikës tradicionale dhe synimit për muzikalitet që ia ka frymëzuar poetit kënga popullore.

Po qe se Kadareja meditante mbi realitetin, Agolli i këndon jetës zëplotë si një zog. Muzikaliteti i poezisë së tij nuk është muzikaliteti i rafinuar i Poradecit apo i Nolit që synonin të zbulonin të gjitha nuancat të ëmbëlsisë së shqipes (i pari) apo të ashpërsisë së saj (i dyti), po është një muzikalitet i veçantë, agollian, një muzikalitet prej burimi që rrjedh në mes të blerimit.

* * *

Pamë se në periudhën e dytë të krijimtarisë në poezinë e Agollit problematika ekzistenciale pasurohet dhe zë më shumë vend. Aty zënë vend motive të reja, motivi i mallit për rininë që ikën, e dhimbjes për shkurtësinë e

jetës, e brengës për zhgënjimet, e gëzimit të të qenit gjysh (Mbesa Ana i frymëzon lirika të ngrohta dhe plot humor plot me dialogje të gjalla).

Pranë temës pannjerëzore të dashurisë që vazhdon të gjallojë, shfaqet tema e jetës, e kuptimit të saj, e enigmave të saj si edhe tema e vdekjes që poeti e trajtonte dikur më tepër në rrafsh heroik dhe stoik, po edhe tani, kur mund të ngjajë më e afërt lëvrohet nga poeti me një guxim sfidues dhe madje me humor (mund të sjellim ndërmend vargun e një prej krijimeve të fundit (“paska dehur vdekjen ky lugat!”)⁵⁵ ose me një lirizëm të butë meditativ dhe nëpërmjet një figuracioni shprehës (të kujtojmë metaforën e fuqishme “trupi im një anije e vjetër / Erdh koha spirancat të hedhë / Në detin e barit të gjelbër”).

Tema e atdheut rikthehet në motivet për Kosovën ku rrjedh më tepër se patosi heroik, nostalgjia për heroizmin. Poeti, nëse i ka humbur iluzionet politike, s’e ka humbur guximin qytetar prandaj vazhdon të trajtojë temën politike e shoqërore duke i fshikulluar dukuritë negative të realitetit të sotëm.

* * *

Agolli mbetet poet i qartësisë dhe thjeshtësisë. Në të dyja periudhat ai ruan parapëlqimin për detajin, pavarësisht nga metaforat dhe krahasimet e freskëta.

Në periudhën e dytë të krijimtarisë së tij ka shtuar muzikalitetin, po pa e zëvendësuar si mjaft poetë në fund të krijimtarisë së tyre, me kultin e ftohtë të formës vrullin rinor të brendshëm. Qartësia dhe thjeshtësia e poezisë së tij lidhen me prirjen për të poetizuar të zakonshmen dhe me çiltërsinë që nuk e lejon të marrë poza, as të rendë pas modash që do ta shtynin të tradhtonte thelbin e individualitetit të vet krijues; kanë në vetvete edhe kufizimet që i vijnë nga shpërthimet spontane të frymëzimit të palëmuara nga lima dhe që sjellin prolisitet apo nga disa thjeshtëzime.

Si një gur që rrokulliset nga mali kjo poezi ka lëvizjen dhe forcën.

Agolli është një nga poetët që këndojnë deri në fund dhe të cilëve vetëm vdekja ua mbyll gojën si thotë vetë ai me humor të këndshëm në një poezi.

BIBLIOGRAFI

Ali Aliu, *Kërkime*, Prishtinë 1971, f. 45-55.

Diana Çuli, *Poemat e Dritëro Agollit*, “Studime filologjike”, 1978, nr. 3, f. 91-120.

Floresha Dado, *Letërsi e painterpretuar*, Shtëpia Botuese “Bota Shqiptare”, Tiranë 2012, f. 227.

⁵⁵ D. Agolli, *Lypësi i kohës*, Shtëpia Botuese “Enciklopedike”, Tiranë 1995, f. 33.

- Dilaver Dilaveri, *Pjekuria e një talenti*, "Nëndori", 1970, 5, f. 42-58.
- Kolë Jakova, *Raporti traditë-novatorizëm*, "Nëndori", 1971, 2, f. 25-30.
- Adriatik Kallulli, *Artikuj kritikë*, Tiranë 1968, f. 37-52.
- Adriatik Kallulli, *Mbi krijimtarinë poetike të Dritëro Agollit*, Nëntori XX, 1973, nr. 3, f. 55-69.
- Adriatik Kallulli, *Devoll, Devoll, Në frontin e letërsisë*, Tiranë 1974.
- Ndue Zef Toma, *Veçori të formës artistike të poemave të D. Agollit*, Nëntori XXX, 1983, nr. 12, f. 41-49.
- Çapajev Gjokutaj, *Poemë për vitalitetin e popullit në shekuj*, "Nëntori", 1975, nr. 3, f. 13-21.
- Shaban Sinani, *Njeriu dhe dukuria atipike në veprën e D. Agollit*, Për letërsinë shqipe të shekullit 20, Shtëpia Botuese "Naimi", 2011, f. 268.
- Dalan Shaplllo, *Frymëzim nga jeta shqiptare*, Dukuri dhe vepra letrare, Tiranë 1974, f. 172-179.
- Dhurata Shehri, *Kolektivizimi i subjektit lirik, Letërsia shqiptare dhe realizmi socialist*, "Studime Albanologjike" 2010, 2, f. 87.
- Vangjush Ziko, *Heroi lirik i poezisë*, "Nëntori", 1982, nr. 12, f. 114-119.

SUMMARY

Individual poetic of Dritëro Agolli towers for its originality in group of avangarde of the years '60, in which the poet stays near Kadare and Arapi.

This group makes resistance to rigid rules of socialist realist and modernist courses, realizing in this way a change in albanian poetry of this period. Agolli's poetic is poetic of the detail and clearness.

In this poetry he brings the spiritual world of the peasant, renews the poetical vocabulary which had been solidified from some traditional romantic - folkloric models, opening the doors to usual lexicon, conversational and not poetical in appearance.

This poet uses denominations of fauna and flora and exploits the prosperity of popular phraseology. In the base of this poetry Agolli doesn't put traditional metric but now the genuine free verse.

He likes the broken verse or regular one. Not rarely he substitutes the rhyme with the assonance. Nevertheless he doesn't sacrifice the musicality but, he possesses his musicality.

Poet is much near with folklore from which he gets the healthy philosophy for the life, the death, the love. He also gets fresh and spontaneous

figuration, some motives, some kinds of verses like sixsyllables, eightsyllables, tensyllables and, in some cases, a characteristic strophe, like distich.

Agolli's poetry is a polychromatic one. We find in it different colours like: white, black, red, golden, sky-blue, grey, green, yellow.

Agolli knows how to create passages and portraits which means that he is a painter poet.

A very important feature of Agolli's poetry is the fiery love for life and its joys. This gives to his creation the inner vitality.

Lyrical hero of Agolli is a double one: from one side he is the intellectual of rural origin, full of strong passions, the fighter that defends the new against the old phenomenon.

On the other side he is an urchin child with his sincerity and naivety.

Agolli's poetry is spragled in two different social - politic periods.

Poet evokes from one period to another, staying faithful to his individuality. In the first period he shows his poetic illusions. But creator triumphs over the ideologist. In this way, the most of his verses survives thanks to its panhuman and literality. As for the second period, Agolli turns to original realism and he enriches his poetry in an existential measure.

A characteristic of Agolli's poetry is the human which is spread in both periods of creation of this author. The key word of Agolli's poetic are: Earth, Slush, Stone, Road, Traveller. During the last period to these words are added the keywords: Pilgrim, and Bell with which, in religious breath is identified lyrical hero. Agolli remains the poet of sincerity and simplicity.

In both periods he keeps the accord for detail, apart from the metaphors and fresh comparisons.

In his second period of the creation Agolli added the musicality but, without replacing, like many other poets in the end of their creation, the inner joyful impetus with cold cult of form. The clearness and simplicity of his poetry are connected with the tendency to turn in poetry the usual and withy frankness which doesn't let to pose, now to run after the fashions which would push to betray the essence of his individuality of creation.

These features are also connected with some limitations that come from spontaneous eruptions of inspiration, unfixed by the file which brings prolixity or any simplicity.

In essence, this poetry towers for its vital freshness, originality and spontaneity.